

SINDIKATA E PAVARUR E MINATORËVE TË SHQIPËRISË –SPMSH

Presidenti i SPMSH pranë minatorëve të industrisë së bakrit për zgjidhjen e problemeve



Prej dy ditësh President i SPMSH-së z. Gëzim Kalaja, i shoqëruar nga stafi i tij z. Sami Kariqi dhe z. Jonuz Xhetani zv. Presidentë të SPMSH dhe avokatja e BSPSH-së znj. Arjola Alikaj, zhvilluan takime të rëndësishme me minatorët e Minierës së Bakrit të Lakut të Roshit, Fabrikës së Pasurimit në Fushë Arrëz dhe Minierës së Bakrit Munellë.

Në takimet e zhvilluara me punonjësit e industrisë minerare të Fushë Arrëzit morën pjesë dhe z. Gjon Zeka, Kryetar i BSP-së të Rrethit Pukë, Vlash Toplana, Vasil Ndoji, Gjovalin Vilapërkatesisht drejtuesit e Sindikatës së Rrethit Pukë dhe të Industrisë Minerare.

Në takim me minatorët u diskutuan probleme të rëndësishme dhe u informuan për situatën e krijuar pas vendimit të kompanisë për reduktimin e numrit të punëtorëve si rezultat i varfërimit të shtresës së mineralit.

SPMSH ka zhvilluar dy takime me përfaqësues të kompanisë BERALB Sh.a për zgjidhjen e problemeve të lindura dhe do të vazhdojë t'i japë rëndësi dialogut me kompaninë për realizimin e kërkesave të minatorëve dhe të punonjësve të Fabrikës së Pasurimit Fushë Arrëz.





Das një dialogu social të suksesshëm



Presidenti i SPMSH pranë minatorëve të industrisë së bakrit për zgjidhjen e problemeve



Presidenti i SPMSH pranë minatorëve të industrisë së bakrit për zgjidhjen e problemeve
[ketu](#) për të shkarkuar [Akt-Marrëveshjen](#) .